

Shkurt 2007

Armët e vogla dhe siguria  
e njerëzve në Kosovë  
Agjenda për veprim



VENDISIGURTË  
BEZBEDNOMESTO  
SAFEPLACE



Forumi i Iniciativës Qytetare Forum of Civic Initiative

Forumi i Iniciativës Qytetare Forum of Civic Initiative



Forumi i Iniciativës Qytetare (FIQ) është një organizatë jo-qeveritare kosovare që promovon përfshirjen e qytetarëve kosovarë në proceset shoqërore dhe të vendimmarrjes përmes programeve të ideuara për të përqendruar vëmendjen në vlerat dhe funksionimin e një shoqërie të hapur dhe demokratike.



Saferworld është një organizatë e pavarur jo-qeveritare që punon me qeveritë dhe shoqërinë civile në rrafshin ndërkombëtar për të hulumtuar, promovuar dhe zbatuar strategjitë e reja për të ngritur sigurinë e njerëzve dhe për të parandaluar dhunën e armatosur.

Armët e vogla dhe siguria  
e njerëzve në Kosovë  
**Agjenda për veprim**

---

**Falënderimet**

*Ky shënim udhëzues është përgatitur nga Astrit Istrefi  
(Forumi i Iniciativës Qytetare) dhe Anna Richards,  
Simon Rynn, Henry Smith dhe Juliana Sokolová  
(Saferworld).*



## 1. Hyrje

Padyshim, shtimi dhe keqpërdorimi i armëve të vogla dhe të lehta (AVL) paraqet një sfidë të përgjithshme për stabilitetin në Kosovë. Kjo sfidë do të jetë më e theksuar me afrimin e vendimit mbi statusin përfundimtar. Kësaj i shtohet edhe fakti që ushtrimi i kontrollit të AVL-ve në Kosovë që nga përfundimi i konfliktit në vitin 1999 ka qenë përplot me vështirësi.

Arsyet kryesore për këtë kanë qenë një sërë rregullimesh politike komplekse të paraqitura pas konfliktit, të cilat vendosin territorin nën administrimin e përkohshëm ndërkombëtar (UNMIK) me praninë ndërkombëtare të sigurisë (KFOR), të udhëhequr nga NATO deri në vendosjen e statusit përfundimtar të territorit. Derisa shumë kompetenca i janë kaluar Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse (IPVQ), shumë aspekte të kontrollit të AVL-ve mbasin përgjegjësi e ndërkombëtareve e jo e akterëve kosovar. Është kritike për sigurinë dhe zhvillimin e ardhshëm të Kosovës që të sigurohet një sistem praktik dhe efektiv i kontrollit të AVL-ve.

Ky shënim udhëzues shpjegon rëndësinë e kontrollit të AVL-ve në Kosovë dhe propozon një sërë masash praktike, të cilat qeveria dhe autoritetet ndërkombëtare në Kosovë së bashku me shoqërinë civile duhet ndërmarrë në muajt vijues, në mënyrë që të bëhet një kontroll më i mirë i AVL-ve dhe të përmirësohet siguria e njerëzve. Pikënisja e kësaj është "Hulumtimi i AVL-ve në Kosovë", një hulumtim i përbashkët i drejtuar nga organizatat joqeveritare Forumi i Iniciativës Qytetare (FIQ) dhe Saferworld, në periudhën shkurt-qershor 2006, me kërkesën e Programit Zhvillimor të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNDP) dhe Qendra e Evropës Juglindore dhe Lindore për Kontrollimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (SEESAC).

Gjithashtu, janë bërë edhe disa hulumtime të fokusuara veçanërisht në transferin e AVL-ve dhe mallrave dhe shërbimeve të ngjashme, si dhe përdorimin e forcës dhe armëve të zjarrit nga personeli i kompanive private të sigurisë, të drejtuar nga Saferworld dhe partnerët e tij. Rekomandimet nga këto hulumtime ofrojnë një plotësim të detajuar të çështjeve të ngritura këtu<sup>2</sup>.

Në muajt e fundit, IPVQ-të dhe UNMIK-u kanë demonstruar një angazhim në Kontrollin e AVL-ve, duke marrë pjesë në Hulumtimin e fundit të AVL-ve 2006, dhe me krijimin e një grupi punues ndërmësor mbi kontrollin e AVL-ve të mbledhur nga UNDP-ja. Për më shumë, dy zhvillime të tjera do të mund të ofronin mundësi të reja për krijimin e një sistemi të kuptueshëm të kontrollit të AVL-ve në Kosovë në vitin 2007. E para prej këtyre është kompletimi i Rishikimit të Sektorit të Sigurisë së Brendshme (RSSB), një proces njëvjeçar i drejtuar nga KB-ja për të vlerësuar nevojat e sigurisë në Kosovë dhe për të krijuar një arkitekturë të re të sigurisë së brendshme për territorin. Ndërmjet rekomandimeve të tij, kontrolli i AVL-ve është një fushë, e cila ka nevojë për një përkujdesje të veçantë. E dyta prej këtyre është nisja e iniciativës së UNDP-së në Kosovë për Kontrollin e Armëve të Vogla (KOSSAC), e cila ka objektiva të qarta në lidhje me përmirësimin e bashkëpunimit dhe koordinimit të intervenimeve të Kontrollit të AVL-ve ndërmjet agjencive të ndryshme të përfshira, si dhe me përfshirjen në zhvillimin e një strategjie të integruar të Kontrollit të AVL-ve.

Hulumtimi i AVL-ve 2006 në Kosovë, i drejtuar sipas udhëzimeve hulumtuese të lëshuara nga UNDP-ja, mbulon katër fusha kryesore të analizave: shpërndarjen e AVL-ve nëpër Kosovë; ndikimin e AVL-ve në sigurinë njerëzore; qëndrimin e

<sup>1</sup> Sokolová J et al, *Hulumtimi i Armëve të Vogla dhe të Lehta në Kosovë*, (Saferworld/SEESAC, 2006). Mund të gjendet në adresën: <http://www.saferworld.org.uk/publications.php?id=223>.

<sup>2</sup> Isbister R et al, *Analiza e Legjislacionit Nacional mbi Eksportet dhe Transferet e Armëve në Ballkanin Perëndimor*, (Saferworld/SEESAC, 2006). Mund të gjendet në adresën: <http://www.saferworld.org.uk/publications.php?id=225>. Page M et al, *AVL dhe Kompanitë Private të Sigurimit në Evropën Juglindore: Një Shkak apo Efekt i Pasigurisë?* (Saferworld and International Alert/SEESAC, 2005). Mund të gjendet në adresën: <http://www.saferworld.org.uk/publications.php?id=13>.

---

publikut ndaj AVL-ve dhe sigurisë në komunitetet e tyre; dhe kapacitetin e institucioneve për t'iu adresuar në mënyrë efektive problemeve të AVL-ve. Janë përdorur disa metoda gjatë hulumtimit, përfshirë edhe hulumtimin familjar në mbarë Kosovën me 1,258 të intervistuar, dhjetë diskutime në fokus grupe, intervista me më shumë se njëqind zyrtarë dhe analist të rëndësishëm, dhe rishikimin e shënimeve zyrtare dhe raporteve të mediave. Përfundimet e hulumtimit, së bashku me rekomandimet e ekipit hulumtues, i janë dërguar IPVQ-ve

dhe autoriteteve ndërkombëtare si një draft formë, në një diskutim (tryezë të rrumbullakët), në maj të vitit 2006. Si vazhdimësi e publikimit të hulumtimit në shtator 2006 (konstatimet kryesore të të cilit janë përmbledhur mëposhtë), ky shënim paraqet një grup të rekomandimeve të rishikuara dhe freskuara, të cilat duhen mbikëqyrur së bashku me punën për përmirësimin e sundimit të ligjit dhe përmirësimin e sigurisë në komunitet në këtë territor.

## Shpërndarja e AVL-ve

- Deri në qershor 2006, kishte përafërsisht 400,000 AVL në Kosovë. Prej këtyre, 33,936 ishin në posedim legal të qytetarëve individual; 45,217 ishin në duart e agjencive zyrtare dhe kompanive ndërkombëtare private të sigurimit; dhe së paku 317,000 ishin në posedim të paligjshëm të qytetarëve individual dhe grupeve të tjera.
- Vendimet apo planet e fundit për të armatosur një pjesë të punonjësve të doganave dhe shërbimit të pylltarisë mund të paraqesë një trend në rritje e sipër drejt pajisjes me armë të zyrtarëve shtetëror, të cilët janë të autorizuar që të përdorin forcën detyruese.
- Për momentin ekziston një sistem i dyfishtë për pajisjen me armë të kompanive private të sigurimit, ku kompanitë ndërkombëtare dhe personeli i tyre kanë të drejtë të mbajnë armë, ndërsa kompanive vendore ose personelit të tyre u ndalohej të mbajnë armë.
- Zyrat e dëshmimeve të ShPK-së shpesh kanë sasi të mëdha të AVL-ve të konfiskuara, disa prej të cilave janë ruajtur aty për disa vite dhe nuk janë të siguruar në mënyrë të duhur. Sidoqoftë, zhvillimet e ngadalshme gjyqësore bllokojnë procesin e shkatërrimit të shumë armëve.
- Sipas të intervistuarve në grupet e fokusuar, posedimi i armëve është më i theksuar në vendet rurale dhe kufitare, dhe shumë kosovarë janë të mendimit se kjo është e ligjshme duke marrë parasysh nivelin e pasigurisë në këto vende.
- Deri më tani mungesa e kanaleve për sigurimin e ligjshëm të AVL-ve ka penguar çdo përpjekje për të krijuar një sistem të rregullt për regjistrimin e armëve të zjarrit që janë në

## 2. Konstatimet kryesore të Hulumtimit të AVL-ve 2006, në Kosovë

dorë të civilëve. Sistemi i tanishëm për lëshimin e lejeve për armë për qytetarët mund të ketë efekt të paqëllimshëm të legalizimit të disa armëve të paligjshme dhe të zhvillimit të një tregu të paligjshëm për AVL-të.

- Rregulloret dhe procedurat për pajisjen e qytetarëve me licenca për të dalë në gjueti me armë dhe për regjistrimin e armëve të gjuetisë janë ende të paqarta.

### Ndikimi i AVL-ve

- Shënimet mjekësore nga spitali Universitar i Prishtinës tregojnë se ndikimi i keqpërdorimit të AVL-ve në shëndetin publik, ndonëse përbën 3.5% të të gjitha vdekjeve të regjistruara, nuk ka qenë edhe aq i rëndë në periudhën prej vitit 2003 deri 2005. Niveli i lëndimeve nga armët e zjarrit është rritur dukshëm gjatë periudhës së tensionit dhe dhunës së rritur në mars 2004, por ka qenë shumë më i ulët në vitet para dhe pas kësaj periudhe.
- Përgjigjet e dhëna në hulumtimin e familjeve tregojnë se që nga përfundimi i konfliktit, ka gjasa që serbët e Kosovës të kenë qenë viktimat e krimit, të lidhur me AVL-të më shumë se shqiptarët.
- Shpesh ekziston një perceptim si në mesin e shqiptarëve ashtu edhe në mesin e serbëve të Kosovës që anëtarët e grupit tjetër etnik janë të armatosur mirë dhe se posedimi i AVL-ve është i rëndësishëm që të ruhet "ekuilibri i frikës".
- Perceptimet në radhët e bashkësive pakicë shtohen si pasojë e besimit se edhe nëse krimi raportohet ai nuk do të hetohet me përpikëri dhe në mënyrë të duhur, dhe se autorët e krimeve nuk do të vihen para drejtësisë.

- Sipas të dhënave të ShPK-së dhe të grupeve të shoqërisë civile që punojnë në këtë çështje, armët e zjarrit përdoren edhe në incidentet e dhunshme familjare, më së shpeshti nga meshkujt për të frikësuar femrat.

### **Qëndrimet dhe perceptimet në lidhje me AVL-të**

- 87% e të intervistuarve në hulumtimin e familjeve besojnë se armët e paligjshme paraqesin një kërcënim për prosperitetin e Kosovës në të ardhmen. Sidoqoftë, çështjet si papunësia, furnizimi i dobët me energji elektrike, rrugët e këqija dhe problemet mjedisore janë perceptuar si shqetësimet më të mëdha nga të gjitha grupet shoqërore.
- Nga 23.6% e të intervistuarve në hulumtimin e familjeve, të cilët kanë deklaruar se eventualisht do të siguronin një armë, një shumicë dërmuese e tyre (76.8%) kanë deklaruar se arsyeja kryesore për këtë do të ishte për të mbrojtur veten dhe familjen e tyre.
- Mbrojtja e pamjaftueshme nga krimi, e ofruar nga sistemi i drejtësisë penale është cituar si arsyeja më e shpeshtë për posedimin e armëve personale të zjarrit.
- Të intervistuarit serb të Kosovës janë më shumë të prirë të perceptojnë rrethin e tyre të pasigurt sesa grupet e tjera etnike (20% të shqiptarëve të Kosovës kundrejt 84% të serbëve të Kosovës frikësohen se ata mund të jenë viktimë e krimit në të ardhmen).
- Perceptimet e sigurisë ishin më pozitive në vendet ku jeton vetëm një grup etnik.
- Rezultatet e hulumtimit familjar dhe të diskutimeve në grupet e fokusuar tregojnë se shqiptarët i konsiderojnë Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) si organin më të besueshëm

për të siguruar kufirin, pasuar nga Forca e Kosovës (KFOR) e udhëhequr nga NATO. Për dallim nga kjo, gati dy të tretat e të intervistuarve serb të Kosovës mendojnë se forca të 'tjera' duhet të mbrojnë kufijtë e Kosovës. Madje, dëshmitë tregojnë se shumë serbë të Kosovës e perceptojnë ushtrinë serbe si të vetmin organ kompetent dhe të besueshëm për të marrë këtë rol.

- Shumica e shqiptarëve të Kosovës dëshirojnë të shohin TMK-në të bëhet ushtri kombëtare, derisa shumica e serbëve të Kosovës besojnë se ajo duhet të shpërbëhet plotësisht. Madje, ndonëse nuk ka ndonjë bazë për të besuar këtë, por shumë serbë të Kosovës kanë dyshime në lidhje me sasinë dhe llojet e AVL-ve të poseduara nga TMK-ja, të cilat nuk janë deklaruar tek KFOR-i.

### **Kapaciteti për kontrollimin e AVL-ve**

- Korniza ligjore për rregullimin e transferit ndërkombëtar të armëve dhe pajisjeve ushtarake për në Kosovë dhe prej Kosovës ka shumë zbrazëti.
- Programet e mëhershme të grumbullimit vullnetar të AVL-ve kanë mbledhur pak armë, dhe nuk ka pasur një vlerësim të sistematizuar të fushatave të mëhershme, një fakt ky që mund të pengoj përpjekjet në të ardhmen.
- Dëshmitë nga burime të ndryshme tregojnë se nuk do të kishte kuptim që të organizohet një grumbullim vullnetar i AVL-ve në mbarë Kosovën deri pas zgjidhjes së statusit përfundimtar të Kosovës. Gjithashtu, duket se faktorët të cilët do të stimulonin dorëzimin e AVL-ve gjatë një programi të ardhshëm për grumbullimin e AVL-ve janë: 1) vendimi mbi statusin përfundimtar të Kosovës; 2) përmirësimi i kushteve ekonomike; dhe 3), përdorimi i stimuluesve individual ose kolektiv.



- 
- Mossuksesin e programeve të mëhershme të grumbullimit të AVL-ve kosovarët e konsiderojnë të jetë rezultat i frikës së vazhdueshme nga konflikti dhe jostabiliteti dhe si rezultat i besimit shumë të vogël tek ofruesit e sigurisë. Kjo ndjenjë është më e theksuar në mesin e popullatës serbe të Kosovës. Sidoqoftë, një pjesë e konsiderueshme e shqiptarëve të Kosovës e konsiderojnë traditën familjare si faktorin kryesor, që i pengon njerëzit të dorëzojnë AVL-të e tyre gjatë periudhave të amnestisë.
  - Ka dallime të mëdha në mes të të dhënave statistikore që kanë të bëjnë me prodhimin, grumbullimin dhe analizën e statistikave të lidhura me AVL-të që jepen nga institucionet kosovare të shëndetësisë publike dhe atyre që jepen nga institucionet për zbatimin e ligjit. Nuk ekzistojnë të dhëna gjithëpërfshirëse për vdekjet dhe lëndimet e shkaktuara nga armët e zjarrit, gjë që e vështirëson vlerësimin e ndikimit direkt të armëve të zjarrit në shëndetin publik. Fakti që ShPK-ja dhe Policia e UNMIK-ut posedojnë të dhëna të ndryshme e bënë më të vështirë që institucionet të japin përgjigje në politikat publike për ndikimin e AVL-ve.
  - Derisa shumica e institucioneve përkatëse demonstrojnë nivele të kënaqshme të transparencës dhe shkëmbimit të informatave për AVL-të, disa të tjera nuk shprehin vullnetin që të ndajnë këtë njohuri për informimin e një kontrolli më efikas të AVL-ve.
  - Shumica e profesionistëve të sektorit të drejtësisë mendojnë se siguria në gjykata nuk është adekuate. Shumë prej tyre dëshirojnë të kenë mbrojtje shtesë, qoftë duke mbajtur armë apo duke punësuar truproje, si dhe përmendin kërcënimet që janë bërë ndaj tyre.
  - Policisë dhe gjyqësorit i mungon kapaciteti për zbatimin e ligjit që rregullon posedimin e AVL-ve, me probleme të veçanta që ekzistojnë në pjesët veriore të Kosovës për shkak të veprimit të strukturave paralele dhe për shkak të kapacitetit dhe legjitimitetit më të ulët të ShPK-së.
  - Rregullimet institucionale për zhvillimin ose zbatimin e politikave të kontrollit të AVL-ve ende janë shumë të dobëta.

### 3. Prioritetet për përmirësimin e kontrollit të AVL-ve në Kosovë

Rekomandimet e mëposhtme janë të bazuara në ato që gjinden në Hulumtimin e AVL-ve të vitit 2006, të cilat janë zhvilluar pas konsultimeve me IPVQ-të, UNMIK-un dhe organizatat tjera relevante para dhe pas publikimit të hulumtimit. Ato kanë për qëllim paraqitjen e fushave në të cilat nevojitet ndryshimi në mënyrë që të krijohet një kontroll mbi AVL-të në Kosovë. Sidoqoftë, që ato të kontribuojnë në mënyrë të rëndësishme, ato duhet të krijojnë një pjesë të një plani strategjik dhe operues të detajizuar dhe kohor, i cili do të miratohej dhe përkrahej nga departamentet qeveritare dhe institucionet e zbatimit të ligjit. Për më shumë, në mënyrë që kontrolli i AVL-ve të jetë një komponentë efektive në promovimin dhe ruajtjen e sigurisë në komunitet, të gjitha përpjekjet e AVL-ve duhen koordinuar dhe lidhur me një numër programesh reformuese zhvillimore, qeveritare dhe të sektorit të sigurisë në të gjitha nivelet administrative brenda Kosovës.

Në teori, një organ koordinues i nivelit të lartë për kontrollin e AVL-ve, i cili do të bashkonte shumë agjenci relevante (shih treguesin 3 më poshtë), do të çonte këto rekomandime përpara, duke ndarë detyra specifike në mes të anëtarëve të tij dhe duke kërkuar ndihmë nga jashtë kur është e nevojshme.

#### **Përmirësimi i sigurisë njerëzore dhe reduktimi i ndikimit të keqpërdorimit të AVL-ve**

Derisa shumë njerëz në Kosovë mendojnë se kanë nevojë të posedojnë armë për sigurinë e tyre dhe sigurinë e familjeve të tyre, prania dhe përdorimi i AVL-ve shpesh është një faktor i cili dëmton sigurinë në vend. Një fokus më i madh në çfarëdo strategjie për Kontrollin e AVL-ve duhet të jetë në reduktimin e ndikimit të tyre në shoqëri. Kështu rekomandohet që të ndërmerren hapa të shpejtë drejt:

#### *Përmirësimi të kapacitetit të IPVQ-ve për ofrimin e sigurisë*

- Vazhdimin e zhvillimit të strategjisë së caktuar të policisë për të ndaluar krimin e armatosur, duke u bazuar pjesërisht në informacionet e përfshira në Hulumtimin e AVL-ve të vitit 2006, të cilat mund të integrohen në një program më të gjerë të Kontrollit të AVL-ve.
- Përforsimin e kapaciteteve hulumtuese të ShPK-së, sidomos në lidhje me krimin e organizuar dhe të lidhur me armë të zjarrit, për informimin dhe zbatimin e një strategjie të tillë.
- Ndërtimin e kapacitetit të Njesisë së Analizave të Krimin të ShPK-së për të analizuar trendet dhe llojet e krimeve dhe keqpërdorimeve të armëve të zjarrit, dhe ndërtimin e kapacitetit të brendshëm të ShPK-së për të zhvilluar dhe zbatuar një strategji efektive për parandalimin e krimin bazuar në këto analiza.
- Përgjigjet adekuate të policisë ndaj krimin me armë të zjarrit në vendet e identifikuar si më të prekura në Hulumtimin e AVL-ve të vitit 2006, veçanërisht në rajonet e Pejës dhe Prishtinës.

#### *Kontrolli i armëve të paligjshme në qarkullim*

- Nisjen e një vlerësimi të mësimave të mësuara nga proceset e mëhershme të grumbullimit të AVL-ve dhe inicimin e planifikimit për grumbullimet në të ardhmen, që duhet të ndodhin vetëm pas zgjidhjes së statusit përfundimtar të Kosovës.
- Sigurimin që çfarëdo grumbullimi i ardhshëm i AVL-ve civile merr parasysh plotësisht kontrastet gjeografike në mbarë Kosovë dhe arsyet e ndryshme të cilat motivojnë posedimin e armëve.

- Përgatitjen e vendit për grumbullimet vullnetare të AVL-ve, duke përkrahur iniciativat e vendosjes së marrëdhënieve dhe krijimit të besimit, siç janë projektet për sigurinë në komunitet dhe konsiderimin se si të përdoren strukturat ekzistuese gjatë këtyre iniciativave siç janë: Këshillat Lokale për Siguri Publike dhe Këshillat Komunale për Siguri në Komunitet.
- Ofrimi i mbështetjes së caktuar policore për komunitetet në vendet rurale dhe kufitare, të lidhura me strategjitë për kontrollin e kufijve, ku posedimi i paligjshëm i AVL-ve është raportuar të jetë nxitur nga nivelet e larta të pasigurisë.
- Paraqitjen e rregulloreve të reja, në kohën e duhur, për amnestinë e AVL-ve për t'a bërë më të lehtë për amnestinë lokale që të organizohen si përgjigje ndaj qasjeve të komuniteteve individuale.
- Paraqitjen e mekanizmave të përshtatshëm për koordinimin në mes agjencive, konsultimin në komunitet, dhe përkrahjen nga donatorët në nivel lokal para ndonjë periudhe të amnestive/dorëzimeve vullnetare lokale.
- Përmirësimin e sigurisë në zyrat e ruajtjes së dëshmive në stacionet policore të ShPK-së në mbarë Kosovën; përsheptimin e zhvillimeve ligjore për të shmangur ruajtjen e këtyre armëve për periudha të gjata kohore; dhe sigurimin e shkatërrimit të tyre të menjëhershëm pas përfundimit të zhvillimeve ligjore.

### **Rregullimi i posedimit dhe përdorimit civil të AVL-ve**

Legjislacioni aktual mbi posedimin e AVL-ve nga civilët dhe entitetet, përfshirë edhe Kompanitë Private të Sigurimit, derisa përcakton kontrole të rënda dhe masa ndëshkuese relativisht të rënda,

ende nuk është fuqizuar mirë dhe ka shkaktuar disa huti. Është kritike që të adresohet kjo situatë dhe kjo sipas hapave të rekomanduar:

### *Zhvillimin e legjislacionit mbi posedimin e armëve të zjarrit nga civilët*

- Marrëveshjen mbi legjislacionin e ri (preferohet nëpërmes Kuvendit të Kosovës) mbi kontrollin e posedimit të armëve nga civilët, i cili i plotëson zbrazëtitë dhe mundëson qartësi. Legjislacioni i ri duhet të:
  - Rregulloj përvetësimin, posedimin dhe përdorimin e armëve të zjarrit nga civilët dhe entitetet legale joqeveritare, siç janë Kompanitë Private të Sigurimit
  - Qartësoj llojet e armëve, të cilat civilët kanë të drejtë legjitime t'i posedojnë dhe të specifikoj çfarë përbën një armë e gjuetisë dhe armë për vetëmbrojtje
  - Përcaktoj kontrollet e nevojshme të kualifikimeve dhe dokumentacionit, si dhe te përcaktoj organet përgjegjëse për këtë
  - Kërkoj kompletimin e trajnimit të detyrueshëm mbi përdorimin dhe ruajtjen e armëve të zjarrit para lëshimit të licencës për armë zjarri
  - Specifikoj kushtet në të cilat armët dhe municioni i licencuar duhet të mbahen
  - Specifikoj ndëshkimet, të cilat janë realisht të fuqizuara
  - Të jetë konform standardeve të BE-së si dhe praktikës më të mirë
- Siguroj që paraqitja e legjislacionit të ri mbi Kontrollin e AVL-ve paraprihet nga një diskutim publik i udhëhequr nga vendasit mbi

posedimin e paligjshëm të armëve dhe ndikimet e tyre për Kosovën, si dhe një fushatë të vetëdijësimit për informimin e popullatës mbi rregulloret e reja.

- Konsideroj realizimin e hapjes së kanaleve ligjore për posedimin e armëve të zjarrit në Kosovë për të reduktuar kërkesat për armët e paligjshme. Të sigurohet një bazë e fuqishme ligjore dhe institucionale për importin dhe tregtinë e brendshme të armëve të zjarrit, dhe provizionet për mo-nitorimin e tyre të jenë të vendosura para se të merret një vendim kështoj, dhe derisa të merret vendimi mbi këto që u përmenden më lartë të sigurohet që armët e lëshuara nëpërmes Sektorit të Autorizimit të Armëve (SAA) janë marrë vetëm nga rezervat zyrtare.
- Siguroj që para licencimit të armëve për vetëmbrojtje të bëhet një vlerësim rigoroz i armës më të përshtatshme për kërcënimin me të cilin ballafaqohet aplikuesi.
- Rishikoj licencimin dhe rregullimin e Kompanive Private të Sigurimit (KPS), dhe përdorimin e forcës dhe armëve të zjarrit nga punonjësit e KPS-ve. Gradualisht të harmonizohet rregullorja për KPS-të ndërkombëtare dhe vendore, duke paraqitur një ndalim të përgjithshëm mbi përdorimin e armëve të papërshtatshme (p.sh. llojin ushtarak) nga punonjësit e KPS-ve.
- Siguroj një kufi të qartë të roleve në mes të ShPK-së dhe KPS-ve për të shmangur garën e paligjshme në mes të policisë dhe industrisë, dhe të sigurohet një bashkëpunim në mes të sektorëve privat dhe publik me qëllim të parandalimit të krimit.
- Siguroj që profesionistët e sigurisë dhe të drejtësisë janë plotësisht të njoftuar mbi ndonjë legjislacion të ri për kontrollin e

armëve dhe se janë në gjendje të përkrahin atë në mënyrë efektive. Aty ku është e nevojshme të organizohen trajnime të caktuara.

### *Rritjes së kapacitetit të IPVQ-ve mbi zbatimin*

- Të fillohet me zbatimin e rreptë të ndalimeve aktuale mbi posedimin dhe bartjen nga civilët të armëve që nuk janë për gjueti.
- Të ndërmerret një fushatë brenda ShPK-së dhe në mesin e publikut për të promovuar rëndësinë e kontrolleve të rrepta mbi posedimin e armëve, si dhe demonstrimin e politikave të reja të përforcuara.
- Të vazhdohet me përkrahjen e zbatimit të sistemit të pajisur mirë dhe profesional për regjistrimin e armëve.
- Për punonjësit që punojnë brenda stacioneve policore të lëshohen udhëzime dhe të mbahen trajnime mbi kryerjen e kontrolleve të kualifikimit dhe dokumentacionit për aplikuesit që aplikojnë për licencim të armëve të zjarrit, dhe trajnime se si të përgatiten dhe paraqiten raportet tek SAA-ja.
- Të vazhdohet me monitorimin e vendeve të fshehta të armëve në periudhën para dhe pas zgjidhjes së statusit përfundimtar për të përkrahur operacionet e zbulimit kundër grupeve militante apo grupeve të organizuara kriminale.

### **Fuqizimi i rregullimit të transfereve ndërkombëtare të armëve**

Rregullimi i eksportit, importit, transitit, dërgesave të largëta dhe ndërmjetësimit për momentin është i papranueshëm dhe duhet të rindërtohet në mënyrë të hollësishme për të krijuar një sistem efektiv të kontrollit të transfereve ndërkombëtare të armëve dhe

mallrave dhe shërbimeve të ngjashme. Duhet ndërmarrë hapa për të:

- Adoptuar legjislacion të ri mbi kontrollin e transferit të armëve, i cili është plotësisht në pajtueshmëri me Kodin e Administrimit mbi Eksportin e Armëve të BE-së dhe me praktikën më të mirë ndërkombëtare.
- Siguruar që legjislacioni i ri rregullon importin, eksportin, transitin, dërgesat e largëta, porositjen dhe prodhimin e licencuar të armëve konvencionale, pjesëve dhe municionit të tyre, dhe që zbrazëtitë aktuale në këtë fushë të largohen.
- Krijuar kushtet për shqyrtimin paraprak për transferet e armëve të propozuara nga Kuvendi i Kosovës, në mënyrë që të vlerësohet nëse transferet janë në pajtim me nevojat e sigurisë së Kosovës, ligjet dhe normat ndërkombëtare.
- Siguruar që zbatimi i legjislacionit nga qeveria i nënshtrohet mbikqyrjes së Kuvendit nëpërmes mekanizmave, siç është Komisioni parlamentar për siguri.

### **Sigurimi i kontrollit efektiv të mbajtjeve zyrtare të AVL-ve**

Korniza rregulluese aktuale nuk i adresohet efektivisht çështjes së menaxhimit, sigurisë dhe përdorimit të AVL-ve nga agjencitë zyrtare. Duhet ndërmarrë hapa për të:

- Përpunuar Ligjin mbi Policinë sa më shpejtë që është e mundur, për të siguruar që përdorimi i armëve të zjarrit nga policia është në përputhje me Parimet Themelore të Kombeve të Bashkuara mbi Përdorimin e Forcës dhe Armëve të Zjarrit nga Zyrtarët Policor, dhe se mbajtja dhe ruajtja e armëve të zjarrit që i takon ShPK-së është e rregulluar plotësisht. Në ndërkohë, të sigurohet një zbatim rigoroz

i rregulloreve të brendshme të policisë mbi përdorimin e forcës dhe armëve të zjarrit.

- Siguruar që përdorimi dhe ruajtja e armëve të zjarrit nga agjencitë tjera qeveritare të autorizuar për armëmbajtje (p.sh. Agjencia e Pyjeve, Doganat) është rregulluar efektivisht sipas ligjit.
- Siguruar që çfarëdo vendimi i ardhshëm mbi armatosjen e organeve zyrtare që nuk janë të autorizuar të bartin armë për momentin, bazohet në një vlerësim të plotë të kërcënimit dhe nevojës.
- Siguruar që çfarëdo organi zyrtar i autorizuar për mbajtje të armëve të zjarrit nën rregullimet e reja të sektorit të sigurisë i nënshtrohet kontrollit efektiv të rezervave, ruajtjes dhe përdorimit.
- Siguruar që akterët e armatosur të IPVQ-ve kanë kapacitet për planifikimin dhe menaxhimin e prokurimit dhe ruajtjes së AVL-ve dhe municionit, si dhe asgjësimin nëpërmes shkaktërimit në rast të tepricave.

### **Përmirësimi i politikave dhe praktikave të menaxhimit të kufijve**

Kontrollet efektive kufitare janë kritike për sigurinë e Kosovës, dhe gjithashtu janë edhe një mjet i rëndësishëm në luftën kundër krimit të organizuar ndërkufitar dhe trafikimit të AVL-ve. Rekomandohet që të ndërmerren veprime për:

- Vazhdimin e ndërtimit të kapacitetit të autoriteteve të Kosovës, sidomos të Policisë Kufitare, për të drejtuar operacione të udhëhequra nga shërbimi inteligjent për të parandaluar krimin ndërkufitar, përfshirë edhe trafikimin e armëve, së bashku me organet relevante ndërkombëtare.

- Rishikimin e mbledhjes së shënimeve dhe sistemeve shqyrtuese për të identifikuar se si kategoritë e ndryshme të incidenteve kufitare mund të mblidhen dhe publikohen. Një rishikim kësaj do të mundësonte analiza dhe paraqitjen e planeve mbi kërcënimin nga trafikimet në pjesë të ndryshme të Kosovës, si dhe do të ndihmonte operacionet e udhëhequra nga shërbimi inteligjent.
- Pjesëmarrjen në marrëveshjet policore të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal, përfshirë edhe Iniciativën e Evropës Juglindore për Bashkëpunim (IEJB) Qendrën për Luftimin e krimin ndërkufitar, EUROPOL-in dhe INTERPOL-in në përputhje me rezultatet e negociatave mbi statusin përfundimtar.
- Vazhdimin e përkrahjes së punës të grupit punues mbi Menaxhimin Kufitar Integruar, dhe ofrimin e përkrahjes strategjike për të siguruar që grupi ka kapacitete dhe përkrahje politike për zhvillimin e një plani veprues për të luftuar trafikimin e AVL-ve si pjesë e një strategjie më të gjerë të Kontrollit të AVL-ve. Sigurimin që plani veprues identifikon objektiva të qarta strategjike në bazë të një vlerësimi të plotë të rrezikut.
- dhe zbatimin e politikave brenda IPVQ-ve, dhe në mes IPVQ-ve, shoqërisë civile dhe institucioneve ndërkombëtare. Sigurimin e përkrahjes politike, teknike dhe financiare për këtë organ koordinues për një periudhë të gjatë kohore në mënyrë që të krijohen kushtet për sukses dhe të sigurohen ndryshimet e nevojshme në kulturën e punës.
- Zhvillimin e një strategjie dhe plani operacional të kuptueshëm për Kontrollin e AVL-ve, të informuar si nga Hulumtimi i AVL-ve i vitit 2006, ashtu edhe nga rekomandimet e përmbajtura në këtë dokument për të udhëzuar punën e UNMIK-ut/IPVQ-ve për kontrollin e AVL-ve në Kosovë.
- Sigurimin që zhvillimi dhe reforma e sektorëve të sigurisë në Kosovë dhe çfarëdo strategjie në të ardhmen për Kontrollin e AVL-ve për Kosovën, bëhen sipas marrëveshjeve. Kjo duhet të detyroj, përveç tjerash, një pasqyrim të detajzuar dhe një debat publik mbi nivelin e përshtatshëm të armatosjes për të gjitha institucionet në Kosovë, me masa të rrepta mbi furnizimin dhe përdorimin e armëve të zjarrit.

### **Përmirësimi i koordinimit dhe formulimit të politikave**

Koordinimi i pamjaftueshëm në mes të agjencive të ndryshme të angazhuara në kontrollin e AVL-ve dhe formulimi i dobët i politikave, kanë qenë pengesa të mëdha në luftimin e përhapjes dhe keqpërdorimit të AVL-ve në Kosovë. Prandaj, kërkohen marrëveshje të reja bashkëpunimi të cilat kontribuojnë në:

#### *Ndërtimin e mekanizmave për koordinim të politikave*

- Krijimin e një organi të lartë koordinues të Kontrollit të AVL-ve për të koordinuar zhvillimin

#### *Përmirësimin e mbledhjes së shënimeve dhe ndarjes së informacioneve*

- Sigurimin e mbledhjes së njëjtë të shënimeve dhe përpunimit nga institucione të ndryshme qeveritare dhe policore. Veçanërisht duhen paraqitur sisteme të reja dhe duhet vazhduar përmirësimi i mbledhjes së shënimeve ekzistuese për të siguruar prodhim të statistikave të besueshme mbi krimin e lidhur me armë të zjarrit dhe ndikimet në shëndetin publik. Ofrimin e trajnimeve të caktuara për punonjësit e spitalit dhe policisë të angazhuar në mbledhjen dhe përpunimin e shënimeve.



- Sigurimin që politikat janë zhvilluar në bazë të shënimeve të mbledhura dhe ofrojnë përgjigje të përshtatshme për situatën në vend.
- Brenda një afati të shkurtër, përmirësimin e koordinimit në mes sistemeve informative të sigurisë të operuara nga UNMIK-u dhe IPVQ-të. Në një afat më të gjatë, sigurimin që sistemet e ndryshme janë racionalizuar dhe harmonizuar për të mundësuar një tranzicion efektiv nën Kontrollin e IPVQ-ve.

### **Rritja e transparencës dhe përgjegjësisë**

Përgjegjësia e IPVQ-ve dhe agjencive ndërkombëtare të përfshira në Kontrollin e AVL-ve është kyçe për adresimin e përhapjes dhe keqpërdorimit të AVL-ve. Në këtë rast është e rëndësishë së veçantë që të mundësohet dhe inkurajohet përfshirja e Kuvendit dhe shoqërisë civile të Kosovës në këtë fushë. Rekomandohet që të ndërmerren këta hapa:

- Mundësimi dhe inkurajimi më i fuqishëm i pjesëmarrjes më kuptimplote të Kuvendit të Kosovës, qytetarëve dhe shoqërisë civile në çështjet e sigurisë, duke filluar nga vendimet mbi prokurimin dhe licencimin e AVL-ve deri tek shtimi i institucioneve të sigurisë në të ardhmen.

- Sigurimi i qasjes publike në informacionet që kanë të bëjnë me AVL-të, siç janë statistikat e krimit dhe shëndetit publik dhe vendimet e procedurat e policisë për menaxhimin dhe prokurimin e AVL-ve.
- Sigurimi i një kornize, e cila përkrahë mbikqyrjen efektive parlamentare të institucioneve qeveritare mbi çështjet e sigurisë në vend, përfshirë edhe raportimin qeveritar tek parlamenti dhe adoptimin e një ligji mbi lirinë e informimit.
- Përmirësimi i transparencës dhe përgjegjësisë së policisë dhe institucioneve të sigurisë në mbarë Kosovën, përfshirë edhe Policinë e UNMIK-ut, ShPK-në dhe KFOR-in, për t'i demonstruar publikut se keqpërdorimi i forcës ose armëve të zjarrit nuk do të tolerohet.
- Sigurimi që shoqëria civile është e përfaqësuar në organet koordinuese relevante të AVL-ve.
- Rregullimi i kontaktit në mes të organeve qeveritare dhe shoqërisë civile, p.sh. nëpërmes mbajtjes së konsultimeve të rregullta për shoqërinë civile si pjesë e procesit zhvillimor të strategjisë së Kontrollit të AVL-ve.

## 4. Konkluzioni dhe hapat tjerë

Zhvillimet si Hulumtimi i AVL-ve i vitit 2006 dhe programi i UNDP-së KOSSAC, si dhe RSSB-ja i ofrojnë UNMIK-ut/IPVQ-ve mundësi për zhvillimin e mekanizmave në tërë sistemin për kontroll efektiv të AVL-ve. Në mënyrë që kjo mundësi të shfrytëzohet sa më mirë, është e rëndësishme që çështjet e ngritura më lartë të adresohen nëpërmes planifikimit të koordinuar dhe zhvillimit strategjik dhe që të krijohen lidhje të përshtatshme me institucionet dhe proceset relevante. Kështu, rekomandohet që si hap i parë të zhvillohet më tutje grupi punues aktual ndër-departamentor mbi Kontrollin e AVL-ve, i mbledhur nga UNDP-ja në Kosovë në një komision formal të Kontrollit të AVL-ve, i cili është i mandatar që të zhvillojë një strategji dhe plan operacional të Kontrollit të AVL-ve për Kosovën dhe të mbikëqyr zbatimin e tij. Pasi që fusha e Komisionit të Kontrollit të AVL-ve duhet të jetë e kuptueshme, duke marrë parasysh të gjitha fushat e kontrollit konvencional të armëve dhe sigurisë njerëzore, ai duhet të përfshijë përfaqësues nga fusha të ndryshme të departamenteve qeveritare dhe organeve ndërkombëtare,<sup>3</sup> si dhe nga shoqëria civile e Kosovës.

Strategjia e Kontrollit të AVL-ve duhet të zhvillohet për një periudhë të përshtatshme (p.sh. prej tre deri në gjashtë muaj) dhe duhet të mbulojë të gjitha çështjet relevante përfshirë edhe licencimin e civilëve, regjistrimin e armëve, mbledhjen, shkatërrimin, ruajtjen, tregtinë, transferet, posedimin nga vepruesit joqeveritarë, edukimin publik, kundër-trafikimin dhe policinë. Për më shumë, është kritike që kjo strategji të bazohet në analizat e detajzuara të shkaktarëve të tanishëm dhe potencial të konfliktit, si dhe demonstrimin e lidhjes së gjerë të politikave dhe programeve reformuese zhvillimore, qeverisëse dhe ekonomike. Vetëm me adresimin e këtyre shkaktarëve të pasigurisë mund të kontrollohet

efektivisht përhapja dhe keqpërdorimi i AVL-ve. Komisioni për Kontrollin e AVL-ve duhet gjithashtu të konsultohet me mbështetësit tjerë gjatë krijimit të strategjisë, përfshirë edhe organizatat relevante ndërkombëtare, donatorët dhe grupet e shoqërisë civile. Pas marrëveshjes së strategjisë, duhet zhvilluar një plan operues, i cili qartë përcakton përgjegjësinë për zbatimin e elementeve të ndryshëm për vepruesit relevant. Plani, gjithashtu duhet të përfshijë një buxhet dhe afat të qartë të zbatimit, si dhe treguesit për përdorim në monitorimin dhe rishikimin e zbatimit të projektit dhe ndikimin e tij në vend. Një kombinim i IPVQ-ve, Kuvendit të Kosovës, përfaqësuesve ndërkombëtarë dhe të shoqërisë civile duhet më pastaj të monitoroj zbatimin e strategjisë dhe planit operues.

Përvoja demonstroi se ekzistojnë një numër i parimeve udhëzuese, të cilat janë themelore në drejtimin e punës së Komisionit për Kontrollin e AVL-ve dhe për draftimin dhe zbatimin e strategjisë për Kontrollin e AVL-ve. Rekomandohet që parimet në vazhdim (të identifikuar më poshtë) të jenë bazë për përpjekje të ngjashme në Kosovë.

**Parandalimi i konfliktit dhe krijimi i besimit:** Përfitimet e mundshme për krijimin e besimit në mes të palëve në konflikt dhe krijimi i një ambienti të favorshëm për zgjidhjen e konfliktit nëpërmes procesit të themelimit të një Komisioni për Kontrollin e AVL-ve dhe strategjisë për veprim nuk duhen injoruar. Kështu, dialogu mbi këtë çështje duhet të përfshijë përfaqësues nga të gjitha grupet etnike dhe shoqërore të Kosovës dhe shoqërisë së gjere civile. Kjo është e rëndësishme jo vetëm për suksesin e intervenimeve të Kontrollit të AVL-ve, por edhe për krijimin e besimit më të madh dhe masave për krijimin e sigurisë.

<sup>3</sup> Përfshirë, por jo kufizuar vetëm në, Zyrën e Kryeministrit, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Qeverisjes Lokale, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Edukimit, Shërbimin Doganor dhe Shërbimin e Mbrojtjes Kufitare, Ministrinë e Ekonomisë, Zyrën për Sigurinë Publike, Komisionin e Sigurisë të Kuvendit, ShPK-në, OSBE-në, dhe UNDP-në.



**Konsultimet:** Suksesi i programit të Kontrollit të AVL-ve varet nga konsultimet e hapura me të gjithë mbështetësit dhe partnerët relevant, si brenda qeverisë ashtu edhe nga organizatat ndërkombëtare, dhe shoqëria civile, përfshirë edhe vendbanimet me minoritarë.

**Krijimi i një ambienti mundësues:** Është thelbësore që Komisioni i Kontrollit të AVL-ve dhe strategjia e tij të kenë përkrahje të plotë nga nivelet e larta politike, dhe që të ekzistoj një kapacitet i nevojshëm administrativ për operimin e tij. Pasi që Kosova në ditët e sotme po ballafaqohet me disa sfida të rëndësishme, rreziku i krijimit të një "komisioni në letër" si përgjigje ndaj nxitjeve ndërkombëtare, pa ndonjë fuqi apo pronësi reale, duhet të shmanget në të gjitha mënyrat.

**De-politizimi:** Pasi që çështjet e Kontrollit të AVL-ve janë politike në njërin kuptim (programet e suksesshme të kontrollit kërkojnë një përkrahje të plotë nga niveli i lartë qeveritarë dhe një vëzhgim të afërt nga parlamenti), politizimi i paligjshëm i këtyre çështjeve duhet shmangur në mënyrë që zyrtarët e mesëm qeveritarë të jenë të lirë në zbatimin e politikave qeveritare. Duke marrë parasysh ndjeshmërinë e përfshirë në lidhje me statusin përfundimtar të Kosovës, është edhe më e rëndësishme të parandalohet politizimi i Komisionit të Kontrollit të AVL-ve dhe strategjisë së tij. Theksimi i transparencës dhe sigurisë njerëzore mund të tregohen të dobishme për ata të cilët përgatisin dhe implementojnë ndonjë strategji.

**Krijimi i politikave të bazuara në dëshmi:** Strategjia dhe plani i Kontrollit të AVL-ve duhet të pasqyrojnë dëshmitë e mbledhura nga hulumtimet e besueshme.

**Të drejtat njerëzore dhe siguria njerëzore:** Qoftë në kushtet e përdorimit të forcës dhe armëve të zjarrit nga zyrtarët e policisë, ose në kriteret për

udhëzimin e vendimeve për transferet e armëve në destinacionet e largëta, respekti për të drejtat njerëzore, përfshirë edhe të Drejtat Njerëzore Ndërkombëtare dhe Ligjin Ndërkombëtar Humanitar, duhet njohur dhe përkrahur në të gjitha fushat. Përfundimisht, të gjitha intervenimet e Kontrollit të AVL-ve sado teknike të jenë, duhen përqendruar në përmirësimin e sigurisë njerëzore dhe promovimin e të drejtave njerëzore.

**Pronësia:** IPVQ-të duhet të luajnë një rol udhëheqës në zhvillimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e strategjisë dhe politikave të lidhura me Kontrollin e AVL-ve, me përkrahje nga organet relevante ndërkombëtare.

**Përshtatshmëria e politikave:** Çfarëdo strategjie e Kontrollit të AVL-ve duhet të ketë parasysh proceset reformuese, të cilat janë duke u bërë brenda Kosovës (p.sh. reforma e sektorit të sigurisë, reformat qeverisëse dhe administrative). Gjithashtu, duhet bërë dispozita për Komisionin e Kontrollit të AVL-ve për t'u lidhur me strukturat relevante qeveritare dhe ndërko-mbëtare.

**Qëndrueshmëria:** Nëse dëshmohej të jetë një masë efektive për përmirësimin e sigurisë njerëzore, duhen bërë përpjekje për vazhdimin e programit të Kontrollit të Armëve në Kosovë për një periudhë afatmesme deri në atë afatgjatë. Krijimi i një drafti të detajuar të planit veprues për zbatimin e strategjisë së Kontrollit të AVL-ve, me shpenzime të përshtatshme, është një përgatitje themelore për këtë.

**Transparenca, mbikqyrja dhe përgjegjësia:** Është me rëndësi që Kuvendi dhe shoqëria civile të jenë të përfshira në mënyrën e duhur në procesin e zhvillimit dhe zbatimit të programit të Kontrollit të AVL-ve në mënyrë që të sigurohen nivele të larta të përgjegjësisë dhe mbikqyrjes. Për këtë arsye, është e rëndësishme që të vazhdohet me zhvillimin e kapacitetit të Komisionit parlamentar për siguri për kryerjen e këtij funksioni.

## Akronimet dhe shkurtesat

---

<b>BE</b>	.....	Bashkimi Evropian
<b>FIQ</b>	.....	Forumi i Iniciativës Qytetare
<b>RSBS</b>	.....	Rishikimi i Sektorit të Brendshëm të Sigurisë
<b>KFOR</b>	.....	Forcat Mbrojtëse të Kosovës
<b>KOSSAC</b>	.....	Iniciativa e UNDP-së për Kontrollin e Armëve të Vogla në Kosovë
<b>TMK</b>	.....	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
<b>ShPK</b>	.....	Shërbimi Policor i Kosovës
<b>MPB</b>	.....	Ministria e Punëve të Brendshme
<b>MD</b>	.....	Ministria e Drejtësisë
<b>NATO</b>	.....	Organizata e Traktatit Veri-Atlantik
<b>OSBE</b>	.....	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>IPVQ</b>	.....	Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse (Kosovë)
<b>KPS</b>	.....	Kompani Private e Sigurimit
<b>AVL</b>	.....	Armët e Vogla dhe të Lehta
<b>IEJB</b>	.....	Iniciativa e Evropës Juglindore për Bashkëpunim
<b>SEESAC</b>	.....	Qendra e Evropës Juglindore dhe Lindore për Kontrollimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta
<b>UNDP</b>	.....	Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara
<b>UNMIK</b>	.....	Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara Misioni në Kosovë
<b>SAA</b>	.....	Seksioni i Autorizimit të Armëve



VENDISIGURTË  
BEZBEDNOMESTO  
SAFEPLACE

Duke ndërtuar sigurinë në Kosovë  
Izgradimo bezbednost na Kosovu  
Building security in Kosovo

Projekti Vend i Sigurtë është program pune i përbashkët i organizatave joqeveritare Saferworld dhe FIO që mbështetë sektorin e sigurisë në Kosovë për një zhvillim të efektshëm, llogaridhënës dhe të ndjeshëm ndaj konfliktit.

[www.safeplaceproject.org](http://www.safeplaceproject.org)

Saferworld  
The Grayston Centre, 28 Charles Square  
London N1 6HT, United Kingdom  
+44 (0)20-7324-4646  
[www.saferworld.org.uk](http://www.saferworld.org.uk)

Forumi i Iniciativës Qytetare  
Rr. Andrea Gropa, 29  
10000 Prishtinë, Kosovë  
+381 (0)38-248-677  
[www.fiq-fci.org](http://www.fiq-fci.org)